



LAJME **BALLKANI** **SPORT** **SHOWBIZ** **LIFE & STYLE** **KUZHINA** **OPINIONE**
AUTOTECH **FUN** **VIDEO**

Dy persona janë arrestuar për gjuajtje me armë zjarri në Prishtinë dhe Gjakovë gjatë ahengjeve.

Rasti i parë ka ndodhur në Prishtinë ku i dyshuari është arrestuar dhe i është konfiskuar arma.

“Në Prishtinë është arrestuar i dyshuari mashkull K-Shqiptar, pasi që i njëjti gjatë një ahengu familjar ka shtënë me armë zjarri. Njësitë policore nga i dyshuari ka konfiskuar armën me një karikator të zbrazët dhe një gëzhgojë. Me vendim të prokurorit i dyshuari dërgohet në mbajtje”, njofton policia.

Ndërkaq një rast tjetër ka ndodhur në Gjakovë po ashtu në një aheng familjar, ku i dyshuari ka shtënë me armë zjarri.

“Në Gjakovë është arrestuar i dyshuari mashkull K-Shqiptar, pasi që i njëjti gjatë një ahengu familjar ka shtënë me armë zjarri. Njësitë policore nga i dyshuari ka konfiskuar armën me një karikator me tre fishekë dhe tri gëzhgoja. Me vendim të prokurorit i dyshuari lirohet në procedurë të rregullt”, bën të ditur policia.

[Gjakove](#) [Gjuajtje me armë zjarri](#) [Policia e Kosoves](#) [Prishtinë](#)
[Raporti 24 orësh](#)


SHOWBIZ

TË REJAT




URAN ISMAILI

PDK: Kurti e Hoti iu nënshtruan Vuçiqit, irrituese vaksinimi i serbëve në veri nga Serbia



LAJMI I FUNDIT

Vrasja nga i biri, familja nga Prizreni njofton se sot e varrosin babanë



KUFIRI

Nga hynë në Kosovë vaksinat nga Serbia: Policia dhe Dogana nuk kanë asnjë informacion

Lutfi Haziri apo Kujtim Shala kandidat i LDK-së për...